

## **GJYKATA E QARKUT NË PEJË**

**P.Nr.3/10**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT NË PEJË**, me trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësja e EULEX-it Verginia Micheva-Ruseva si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjykatësi i EULEX-it Gianfranco Gallo dhe Gjykatësja Kosovare Elmaze Syka si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Procesmbajtësja Robina Struthers, në çështjen penale kundër të akuzuarit:

**Valon Miftari**, Shqiptar Kosovar, i lindur më 27.03/1980, në fshatin Duznje në Komunën e Gjakovës, me vendbanim në fshatin e njëjtë, i biri i Osman dhe Shkurte Sadrijajt, i shkolluar, i pamartuar, ish Oficer i Policisë së Kosovës nr. 4338, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, aktualisht në liri,

i akuzuar, sipas Aktakuzës PP.nr.598/03 të datës 22.10.2004, të ndryshuar më 24.05.2010, me veprën penale *Vrasje e rëndë* që tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 147 pika 11 në lidhje me nenin 8 para. 3 të KPK.

Pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit gjyqësor më 23 Mars, 13, 27, 28 Prill, 20, 26, 28 dhe 17 Maj 2010 në praninë e:

- Të akuzuarit Z. Valon Miftari dhe avokatit të tij mbrojtës Z. Fazli Balaj;
- Prokurorit Publik të EULEX-it Peter Korneck dhe Prokurorit Kosovar Haxhi Sinanaj,
- Përfaqësuesit të palës së dëmtuar Z. Sokol Dobruna;

Pas shqyrtimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 27 Maj 2010, në bazë të Nenit 391 Paragrafi (1) të KPPK,

Më 27 Maj 2010, në pajtim me Nenin 392 Paragrafi (1) të KPPK, shpall publikisht dhe në prani të palëve, këtë

## **AKTGJYKIM**

I pandehuri Valon Miftari

### **LIROHET**

nga akuza për kryerjen e veprës penale të Vrasjes, sipas Nenit 30 para. 1 dhe 3 të LPK (1977), të Sadik Zenelit në fshatin Duzhnje, komuna e Gjakovës, më 8 Nëntor 2003, pasi që ekzistojnë rrethana (Mbrojtje e Nevojshme) që përjashtojnë përgjegjësinë penale sipas nenit 390 para. 1 pika 2 të KPPK.

I pandehuri Valon Miftari

### **SHPALLET FAJTOR**

për kryerjen e veprës penale të Vrasjes sipas nenit 30 para. 1 të LPK (1977) në lidhje me nenin 9 para. 3 të RSFJ KP, akuza është kualifikuar ashtu, sa i përket vrasjes së Sefedin Zenelit, sepse më 8 Nëntor 2003 rreth orës 17.00 në fshatin Duzhnje, Komuna e Gjakovës, pasi që është sulmuar fizikisht nga Sadik dhe Sefedin Zeneli dhe pasi që ka privuar Sadik Zenelin nga jeta duke vepruar në mbrojtje të nevojshme, duke përdorur revolen e tij zyrtare të tipit GLOCK kalibër 9 mm, duke vepruar në tejkalim të vetëmbrojtjes, ka shtënë dy herë në Sefedin Zenelin, i cili ishte duke e sulmuar atë duarthatë, dhe kështu e ka qëlluar Sefedin Zenelin në fytyrë dhe në dorën e majtë dhe ka shkaktuar vdekjen e tij.

PRANDAJ sipas Nenit 30 para. 1 të LPK (1977), në lidhje me Nenin 9 para. 3 dhe Nenin 43 para. 1 pika 1 e KP RSFJ, i akuzuari

### **DËNOHET**

me tetë (8) vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga 8 Nëntori 2003 deri më 24 Nëntor 2003 dhe nga 12 Qershori 2006 deri më 11 Dhjetor 2009 do të llogaritet në dënim, sipas Nenit 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5 dhe Nenit 278 Para. 7 të KPPK.

I akuzuari do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 500 Euro sipas Nenit 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit.

## **ARSYETIMI**

### **Historia procedurale**

Më 8 Nëntor 2003, në ose rreth orës 17.00 në fshatin Dushnje, komuna e Gjakovës, Sadik Zeneli dhe Sefedin Zeneli janë qëlluar me armë zjarri për vdekje. I pandehuri, i cili në kohën e ngjarjes ishte oficer i PK, është arrestuar në të njëjtën ditë.

Me aktakuzën e datës 2 Tetor 2004 Prokurori Publik i Qarkut në Pejë e ka akuzuar të pandehurin me Vrasje të çastit (vrasje të provokuar) sipas nenit 33 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) dhe si alternativë me vrasje të kryer në gjendje të afektit mendor sipas nenit 148 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK). Me aktvendimin e datës 22 Nëntor 2004 Gjykata e Qarkut në Pejë e ka konfirmuar aktakuzën.

Shqyrtimi gjyqësor është kryer me një trup gjykues të përbërë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 prej dy gjykatësve ndërkombëtarë dhe një gjykatësi vendor. Gjatë shqyrtimit gjyqësor (12 Prill-12 Qershor 2006) prokurori ka paraqitur një aktakuzë të ndryshuar, duke e akuzuar të pandehurin me disa vrasje sipas nenit 30 para. 1, 2 dhe 3 të LPK. Trupi gjykues, më 12 Qershor 2006, e ka shpallur të pandehurin fajtor për dy vepra penale të vrasjes (privim të qëllimshëm nga jeta të Sadik Zenelit dhe Safedin Zenelit) sipas nenit 30 para. 1, 2 dhe 3 të LPK dhe ka shpallur dënimin prej 13 viteve burgim për secilën vrasje duke rezultuar në dënimin unik prej 15 viteve burgim.

Më 22 Nëntor 2006 avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur ankesë kundër aktgjyqimit në bazë të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit

të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal në dëm të të pandehurit dhe sa i përket vendimit mbi sanksionet penale.

Gjykata Supreme e Kosovës në një kolegji të përbërë nga tre gjykatës e ka aprovuar pjesërisht ankesën. Me Aktgjykimin e datës 5 Gusht 2008 i pandehuri është shpallur fajtor për dy vrasje për të cilat atij i është shpallur një dënim i vetëm prej 15 viteve burgim. Pjesa tjetër e aktgjyimit është konfirmuar.

Më 13 Nëntor 2008 avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të datuar 11 Nëntor 2008 kundër aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Me aktgjykimin e datës 11 Dhjetor 2009 Gjykata Supreme e Kosovës në një kolegji të përbërë prej tre Gjykatësve të EULEX-it dhe dy Gjykatësve vendorë ka aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 12 Qershor 2006 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 5 Gusht 2008 si të përbërë në shkelje të dispozitave të ligjit penal. Çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në arsyetim Gjykata Supreme e Kosovës ia ka tërhequr vëmendjen gjykatës së shkallës së parë për rëndësinë e shqyrtimit të dëshmimeve të dëshmitarit Blerim Baliaj, ka rekomanduar një rikonstruim të ngjarjeve në kushte të ngjashme të ndriçimit dhe që të aprovohet një ekspertizë psikiatrike nga një panel ekspertësh për të vlerësuar gjendjen mendore të të pandehurit kur i ka vrarë viktimat.

### **Kompetenca e gjykatës**

Aktakuza është ngritur më 2 Tetor 2004 pasi që KPPK-ja ka hy në fuqi (6 Prill 2004). Në pajtim me Nenin 23, paragrafi 1 të KPPK në lidhje me Nenin 29 para. 2 nënpara. 1 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të 1978, Gjykatat e Qarkut do të kenë juridiksion që të gjykojnë, në shkallë të parë, veprat penale që dënohen me më shumë se pesë vite burgim.

Në këtë rast i akuzuari së pari është akuzuar për Vrasje të çastit (vrasje të provokuar) sipas nenit 33 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) dhe si alternativë me vrasje të kryer në gjendje të afektit mendor sipas nenit 148 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

(KPPK), që dënohet me një deri në 10 vite burgim dhe është e pakontestueshme që të dy veprat penale janë brenda kompetencës së Gjykatës së Qarkut.

Veprat penale, sipas aktakuzës, janë kryer në Pejë dhe prandaj çështja bie nën kompetencën territoriale të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Çështja aktuale i është caktuar autoritetit të Gjykatësve të EULEX-it sipas nenit 16.3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-052). Një gjykatës Kosovare ka qenë pjesë e Trupit Gjyqësor gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 4.7 të Ligjit mbi Kompetencat. Sipas nenit 457 dhe nenit 458 të KPPK, një shqyrtim i ri gjyqësor do të mbahet përpara gjykatës së njëjtë apo përpara një gjykate tjetër kompetente të shkallës së parë. Në vendimin e saj të datës 11 Dhjetor 2009 GJS e Kosovës e ka anuluar aktgjykimin e GJQ të Pejës të datës 12 Qershor 2006 dhe Aktgjykimin e GJS të Kosovës të datës 5 Gusht 2008 dhe ia ka kthyer çështjen gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Duke marrë parasysh të lartpërmendurën, gjykata kompetente për të gjykuar rigjykimin e procedurës penale është Gjykata e Qarkut në Pejë. Gjithashtu, sipas nenit 459 të KPPK nëse aktgjyrimi i formës së prerë anulohet dhe çështja kthehet për rigjykim, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme.

Asnjë nga palët nuk ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjyqësor.

### **Shqyrtimi Gjyqësor**

Gjyrimi ka rifilluar më 23 Mars 2010 dhe ka vazhduar i hapur për publikun më 13, 27, 28 Prill 2010, 20, 26 dhe 27 Maj 2010 në prani të të pandehurit Valon Miftari dhe avokatit të tij mbrojtës, Z. Fazli Balaj, Prokurorit Publik të EULEX-it Z. Peter Korneck dhe Prokurorit Publik Kosovare Z. Haxhi Sinanaj, përfaqësuesit të palës së dëmtuar Z. Sokol Dobruna. Janë dëgjuar dëshmitarë-ekspertë të ri dhe janë prezantuar prova të reja materiale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, më 25.05.2010 Prokuroria Publike e Qarkut ka paraqitur një aktakuzë të ndryshuar kundër Valon Miftarit duke e rikualifikuar veprën penale dhe duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë që tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, sipas nenit 147 pika 11 në lidhje me nenin 8 pika 3 e KPK. Sipas prokurorit, më 8.11.2003 rreth orës 17.00 në fshatin Duhnje, Komuna e Gjakovës,

pasi që ai më parë ishte sulmuar fizikisht nga viktimat Safedin dhe Sadik Zeneli, të cilët e kishin goditur të akuzuarin Valon disa herë duke përdorur shkelma dhe grushte, duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit dhe të kokës dhe duke e bërë që të shtrihet në tokë, kur personi i akuzuar nxori revolen e tij zyrtare të tipit “Glock” kal. 9 mm, dhe duke përdorur armën e njëjtë ai ka shtënë në drejtim të viktimave, kur ai fillimisht e privoi nga jeta Sadik Zenelin, të cilin e qëllloi pesë herë me armë zjarri, pas kësaj ai menjëherë, duke përdorur armën e njëjtë qëllloi dy herë në drejtim të Sefedin Zenelit, duke i lënë të dy të vdekur në vendndodhje.

Në pajtim me Nenin 15 të KPK, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore relevante për gjykim në Shqip dhe në Anglisht, sipas nevojës.

#### **Përmbledhja e provave të prezantuara**

Në vendimin e saj për rigjykim, Gjykata Supreme ia ka dhënë tri udhëzime trupit të ri gjykues që do të merrej me çështjen: që të shqyrtojë dëshminë e dëshmitarit Blerim Baliaj, që të bëjë rikonstruimin e ngjarjeve në kushte të ngjashme të ndriçimit dhe që të dëgjojë mendimin e një paneli të ekspertëve psikiatrik me qëllim që të vlerësojë gjendjen mendore të të pandehurit.

Në vijim të këtij vendimi të Gjykatës Supreme, dhe në veçanti të udhëzimit mbi provat e reja që duhet të mbliidhen nga trupi i ri gjykues, me urdhrin e datës 23.03.2010, gjykata ka urdhëruar një ekzaminim psikiatrik të të akuzuarit. Gjithashtu, me qëllim që të identifikojë kushtet e ndriçimit të ngjashëm me ditën kritike, më 14.04.2010 gjykata urdhëroi institutin hidro-meteorologjik të Kosovës që të furnizojë gjykatën me shënime mbi kushtet atmosferike në rajonin ku është kryer vepra penale dhe veçanërisht sa i përket dukshmërisë, si dhe atë se në çfarë kohe të ditës trupi gjykues mund të kryej rikonstruimin e ngjarjeve.

Gjykata ka dëgjuar dëshmitarët Blerim Baliaj dhe dëshmitarin-ekspert Z. Syle Tahirsylaj, Drejtor i Institutit Meteorologjik të Kosovës (seanca e 27 Prillit 2010).

Me pajtimin e palëve sipas nenit 368 para. 1 pika 3 të KPPK në seancën e mbajtur më 28 Prill 2010 gjykata ka konsideruar si të lexuara deklaratat e dëshmitarëve Ymer Jaha, Fazli

Rexhepi, Idriz Jaha, Halil Rrahmanaj, Rustem Jetishi, Blerim Rrahmanaj, Hajdar Sadiku, Riza Rexhepi, Haki Hasani, Gzim Rama, Gazmend Kastrati, Ardian Kurhasku, Faton Aliaj, Skender Fetaj, Skender Sadriu, Xhafer Zeneli, Myreza Zeneli, Matthias Fell, Dr. Marek Gasiar, Isa Bajrami, Maria Morcillo, Yusof Arslankoc, Sahit Jaha, Memli Miftari, Ismet Deliaj dhe Bekim Dervishaj.

Gjatë seancës së njëjtë gjykata i ka lexuar raportet dhe dokumentet në vijim:

- Raporti i autopsisë së Sefedin Zenelit dhe shtesa me skica dhe fotografi të viktimës;
- Raporti mbi mbetjet e të shtënës me armë zjarri;
- Raporti mbi shenjat e pluhurit pa tym në rrobat e viktimës;
- Raporti mjekësor forenzik mbi provat materiale Nr 326/2003
- Skica e vendngjarjes me legjendë dhe fotografi;
- Raporti balistik
- Video intervista e Valon Myftarit;
- Video intervista e Blerim Balijajt;
- Fotografitë e vendngjarjes;
- Fotografitë e lëndimeve të të pandehurit Valon Myftari;
- Raporti mjekësor për Valon Myftarin;
- Raporti i policisë Nr 2003-DI-235, i datuar 09.11.2003;
- Radio regjistri i policit Ismet Delija;
- Raporti i policisë Nr 2003-DI-235 i datuar 10.11.2003 i përpiluar nga OP Frederic Giusto;
- Raporti i policisë i datuar 08.1.2003 i përpiluar nga OP Faton Alija;
- Raporti i policisë i datuar 09.11.2003 i përpiluar nga OP Hajdar Sadiku;
- Raporti i përmbledhjes së rastit Nr 2003-DI-235, i datuar 09.11.2003;
- Përmbledhja e rastit Nr 2003-DI-235 i datuar 09.11.2003;
- Raporti i policisë i datuar 08.11.2003, i përpiluar nga OP Yusuf Arslankoc;
- Raporti i policisë rasti Nr 2003-DI-235 i datuar 09.11.2003 i përpiluar nga OP Shefqet Shabani.

Më 23.04.2010 Kryetari i Trupit Gjykses ka urdhëruar këqyrjen e vendngjarjes dhe rikonstruimin e ngjarjeve që kanë ndodhur më 8 Nëntor 2003, por pas deklaratave të dëshmitarit-ekspert Z. Sylë Tahirsylaj, të dhënë në seancën më 27 Prill 2010<sup>1</sup>, trupi gjykses ka vendosur mos të kryej këqyrjen e vendngjarjes dhe rikonstruimin e ngjarjeve për shkak të pamundësisë që të ketë kushtet e njëjta atmosferike gjatë datës së rikonstruimit siç ishin në ditën kritike. Gjithashtu, vendngjarja ka ndryshuar me kalimin e viteve dhe rikonstruimi i plotë nuk ishte i mundur, Gjykata ka kërkuar sipas detyrës zyrtare dosjen penale të të pandehurit nga Gjykata Komonale në Pejë dhe rezultati ishte që i pandehuri nuk ishte dënuar më parë.

### **Ligji i aplikueshëm**

Sipas nenit 2 para. 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale do të aplikohet sa i përket kryesit. Por në rast të një ndryshimi në ligjin e aplikueshëm në një rast të caktuar para vendimit përfundimtar, do të aplikohet ligji më i favorshëm për kryesin.

Vepra penale është kryer më 8 Nëntor 2003, prandaj në kohën kur aplikohet Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPK, 1977), ndryshuar me Rregulloren e UNMIK 1999/24 (10 Qershor 1999) dhe për më tepër nga Rregullorja e UNMIK 2000/59 (27 Tetor 2000). Për vrasjen e dy apo më shumë njerëzve neni 30 para. 3 në lidhje me para. 2 të LPK parasheh burgim prej së paku 10 vite deri në 40 vite. Në ndërkohë më 6 Prill 2004 KPK ka hy në fuqi. Neni 147 para. 11 i KPK për vrasje të rëndë të dy ose më shumë personave parahesh burgim prej së paku dhjetë vitesh apo burgim afatgjatë.

---

<sup>1</sup> Dëshmitari-ekspert Sylë Tahirsylaj, drejtori i institutit meteorologjik të Kosovës, gjatë seancës më 27 Prill 2010, në pyetjen e trupit gjykses se si ishin kushtet meteorologjike më 8 Nëntor 2003 në ora 17.00, ka deklaruar që temperatura ka qenë 9.45 C, era frynte nga juglindja, qielli ishte me re në 80% të sipërfaqes së tij, lagështia ishte 84%. Përfundimi i diellit në atë ditë ishte në ora 16.19, qielli ishte i mbuluar 10 nga 10, prandaj nuk ishte i mundur penetrimi i dritës nga harku i fundit të diskut të diellit. Dukshmëria ishte e ulët; ishte terr si muzg i parë.

Mbi atë që u tha më parë, fillimisht Kryetari i Trupit Gjykses ka vendosur që të kryej këqyrjen e vendngjarjes dhe rikonstruimin e ngjarjeve më 28 Prill 2010, në pajtim me vendimin e GJS. Prandaj, eksperti u urdhërua që të identifikojë se në çfarë ore të ditës së vendosur për rikonstruim – 28 Prill 2010, kushtet atmosferike do të ishin identike me kushtet atmosferike, duke përfshirë dukshmërinë, të 8 Nëntorit 2003 në ora 17.00 kur ka ndodhur ngjarja në fjalë. Sipas ekspertit më 28 Prill në ora 19.00 kur muzgu fillon (muzgu i parë) kushtet meteorologjike do të ishin 30% të ngjashme me kushtet meteorologjike të 8 Nëntorit në ora 17.00.

### **Pretendimet e palëve**

Sipas **prokurorit publik**, më 8 Nëntor 2003 rreth orës 17.00 i akuzuari është sulmuar nga Sadik Zeneli dhe Sefedin Zeneli të cilët e kanë goditur disa herë duke përdorur shkelma dhe grushte, duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit dhe kokës, duke e bërë që të shtrihet në tokë dhe pastaj ai e ka nxjerrë revolen e tij zyrtare dhe ka shtënë pesë herë në Sadikun dhe dy herë në Sefedinin dhe kështu i ka privuar të dytë nga jeta. I akuzuari është përgjegjës dhe nuk ka asnjë arsye për të konsideruar që i akuzuari ka qenë në gjendje të pezmatimit apo afektit mendor. Sipas prokurorit mund të konkludohet që i akuzuari ka vepruar në vetëmbrojtje pasi që kishte një sulm mbi jetën e tij. Pyetja është nëse vetëmbrojtja ishte e nevojshme. Sipas prokurorit i akuzuari mund të ketë ndaluar sulmin e Sadik Zenelit dhe Sefedin Zenelit pa i privuar ata nga jeta. Sipas prokurorit ekzistojnë rrethana lehtësuese, pasi që i akuzuari nuk ka dosje penale dhe ai ka shfaqur pendim të vërtetë. Gjithashtu, sipas prokurorit, kohëzgjatja e procedurës i ka shkaktuar dëme jetës së të akuzuarit. Prokurori kërkon që i akuzuari të dënohet për vrasje të rëndë sipas nenit 30 para. 3 të KPK dhe kryerje të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 8 para. 4 të KPK.

**Avokati mbrojtës i palëve të dëmtuara** \*(si në origjinal-përkthyesi) i propozon trupit gjykues që të nxjerrë përfundimet e tij në bazë të sugjerimeve të prokurorit, të veçoj dy vrasjet, pasi që motivet ishin të ndryshme. Nëse vrasësi i Sadikut kishte disa motive, veçanërisht nëse ai e ka sulmuar të akuzuarin, për Safedinin i akuzuari ka merituar dënimin maksimal.

**Avokati mbrojtës i të akuzuarit** i propozon trupit gjykues që të pranojë si të pakontestueshme ekzistencën e një sulmi nga viktimat ndaj të akuzuarit. Kontestimi është në faktin nëse Valon Myftari ka vepruar në vetëmbrojtje dhe nëse e ka tejkaluar atë. Sipas avokatit mbrojtës është bërë një sulm i paligjshëm dhe i paprovokuar kundër të akuzuarit dhe mbrojtja e tij ishte e pashmangshme dhe brenda proporcionit të sulmit. Valoni është sulmuar nga dy burra të rritur, të dy prej tyre më të gjatë dhe më të fortë se ai, të cilët kanë përdorur shkelma dhe grushte kundër tij. Sidoqoftë Valoni nuk e ka përdorur armën e tij të zjarrit derisa ka rënë në tokë. Prandaj sipas avokatit mbrojtës vetëmbrojtja ka qenë proporcionale me kërcënimin dhe sulmin. Gjithashtu ai ka kujtuar që dy muaj para veprës Valoni ishte kërcënuar seriozisht për shkak të dhënies së

informatave në një hetim të vrasjes së një polici. Prandaj, sipas avokatit mbrojtës i akuzuari duhet të lirohet nga akuza në pajtim me nenin 8 para. 1 të KPK.

Në fjalën e tij përfundimtare Valon Myftari ka deklaruar që ai qëndron pranë fjalës përfundimtare të avokatit të tij mbrojtës dhe kërkon nga gjykata që të gjitha akuzat ndaj tij të hedhen poshtë. Për më tepër, ai ende shpreh keqardhje për viktimat.

### **Rikonstruimi faktik i ngjarjeve**

Në pjesën pasuese të arsyetimit do të prezantohen deklaratat të ndryshme duke iu referuar ngjarjeve më relevante në çështjen aktuale.

### **Ngjarjet para vrasjes:**

Sipas të pandehurit marrëdhëniet në mes të familjes së tij dhe familjes së viktimave kanë qenë normale. Megjithatë, dëshmitari **Xhafer Zeneli**, vëllai i viktimës Sadik Zeneli, ka deklaruar në shqyrtimin gjyqësor më 3 Maj 2006<sup>2</sup>, që Sadik Zeneli dhe babai i Valonit kishin pasur një grindje dhe babai i Valonit kishte dashtë ta vriste Sadikun. Sadiku e akuzonte babanë e Valonit që gjatë luftës ai ka qëndruar në anën e Serbëve<sup>3</sup>. Sipas dëshmitarit **Myrte Zeneli**, babai i viktimës Sefedin Zeneli, marrëdhëniet në mes të Sefeditit dhe Valonit ishin të mira para ditës kritike. Ky dëshmitar gjithashtu ka konfirmuar që ka qenë një grindje në mes të Sadik Zenelit dhe babait të Valonit në lidhje me pjesëmarrjen në UÇK<sup>4</sup>. Në 2003 i pandehuri ka qenë një polic i ri me 3 vite eksperiencë profesionale. Sipas dëshmitarit **Faton Aliaj**<sup>5</sup>, Valoni ka qenë i rreptë në veprimet e tij dhe ai si shef i tij nuk ka vërejtur ndonjë shkelje të urdhrave nga Valoni.

Sipas të akuzuarit para ngjarjes kritike ka ndodhur një vrasje e një polici nga Peja, Hajdar Ahmeti. Sipas Valonit, Sadik Zeneli ka qenë i përfshirë dhe sipas tij kjo ka qenë arsyeja pse Sadik Zeneli i është afruar atij më 8 Nëntor 2003 dhe ka dashtë ta vret atë. Për këto pretendime dëshmitari **Skender Fetaj**, polic dhe hetues i vrasjes së Hajdar Ahmetit në Nëntor 2003 ka deklaruar<sup>6</sup> që njëri prej dëshmitarëve në atë rast e kishte njohur Sadik Zenelin si njërin prej njerëzve që kanë qenë te vetura që ishte afër vendngjarjes kur është

---

<sup>2</sup> Faqja 18 e procesverbalit

<sup>3</sup> F.19, procesverbali i 3 Majit 2006

<sup>4</sup> F. 24, procesverbali i 3 Majit 2006

<sup>5</sup> Deklarata e dhënë më 3 Maj 2006

<sup>6</sup> Shih procesverbalet përpara trupit gjykues, 19 Prill 2006

vrarë Ahmeti. Por ai dëshmitar nuk është shumë i sigurt që Zeneli me të vërtetë ishte ai njeri.

Dëshmitari **Hajdar Sadiku**, gjithashtu polic i Kosovës, gjatë dëshmisë së tij më 21 Prill 2004, i ka deklaruar trupit gjykues që ai gjithashtu ka qenë i përfshirë në hetimin e vrasjes së policit të PK Hajdar Ahmeti. Ai e ka pyetur Valonin për personin i cili, sipas informatave të inteligjencës, mund të jetë i dyshuar në vrasje dhe përshkrimi i të cilit i përngjanë një personi i cili jeton në fshatin Duzhnje, ku ka jetuar Valoni. Në lidhje me këtë Valoni i ka thënë dëshmitarit që ai nuk ka pasur marrëdhënie të mira me Sadikun. Sipas dëshmitarit Valoni kishte qenë i kërcënuar.

### Ngjarja

Sipas dëshmitarit **Adrain Kurhashu**, polic i Kosovës në stacionin e policisë në Pejë, më 8 Nëntor 2003, pas orës 17.15 përdërisa ishte në detyrë ai e morri një thirrje anonime telefonike për një vrasje që sapo kishte ndodhur në fshatin Duzhnje. Rreth 15 sekonda më vonë Valon Myftari lajmëroi në radio të policisë në Pejë: “dy persona tentuar të ma kapin revolen dhe më duket që i kam vrarë të dytë”.

Dëshmitarët **Gëzim Rama dhe Gazmend Kastrati**, polic të Kosovës në detyrë atë ditë, kanë dëshmuar që pas rreth 15 minutave pasi që ata e kanë lënë Valonin në fshatin Duzhnje, ata e kanë dëgjuar atë duke folur në radio që “ai i kishte qëlluar dy persona”<sup>7</sup>.

Dëshmitari **Ymer Jaha** i ka parë viktimat dhe të akuzuarin pak para ngjarjes<sup>8</sup>. Ai ka qenë në oborr të dyqanit të tij së bashku me Sefedinin dhe i ka parë Valonin dhe Sadikun në oborr. Sadiku ishte gati për të u larguar por Valoni e ndali atë dhe i tha diçka. Ai nuk ishte i sigurt nëse ata grindeshin apo qeshnin, por ata nuk kanë hy në dyqan. Dëshmitari dhe Sefedini kanë hy në dyqan së bashku. Brenda në dyqan ishin edhe Fazli Rexhepi, Idriz Jaha, Sahit Jaha dhe Raghip Haxhijaja. Sefedini i ka thënë dëshmitarit që ai ka dashtë të shih se çfarë po bënin Sadiku dhe Valoni përjashta dhe ka dalë nga dyqani. Pas pak kohe dëshmitari ka dëgjuar disa zhurma (tri apo pesë) të cilat nuk ka mundur të i identifikojë. Ai ka menduar që janë rrëzuar rrota nga garazhi i tij dhe menjëherë ka dalë jashtë. Ai e ka dëgjuar Valonin duke thënë “Kuku, i vrava dy persona”. Pastaj Valoni ka

---

<sup>7</sup> Deklaratat e dhëna përpara gjykatësit hetues në 2004

<sup>8</sup> Shih procesverbalet përpara trupit gjykues, 19 Prill 2006

vrapuar për në shtëpinë e tij me pistoletë në dorë. Dëshmitari i ka parë dy kufoma të shtrira në rrugë.

Dëshmitari **Fazli Rexhepi**<sup>9</sup> ka parë kur Sefedini ka hy në dyqan dhe kur ai ka dalë, dhe pas disa minutash dëshmitari i ka dëgjuar tri zhurma të cilat ai ka menduar që janë nga shpërthimi i gomave. Por atëherë ka ardhur Ymer Jaha dhe i ka thënë atyre që Sadiku dhe Sefedini ishin vrarë.

Dëshmitari **Idriz Jaha**<sup>10</sup> i ka konfirmuar deklaratat e dy dëshmitarëve të mëparshëm.

Dëshmitari **Rrustem Jetishi**<sup>11</sup> ka deklaruar që ai ka qenë me Memlin, një nip të Valon Myftarit, duke e shikuar një lojë futbollit në stadium afër rrugës në fshatin Duzhnje. Ai ka dëgjuar të shtëna, gjashtë apo shtatë. Pastaj ai dhe Memli kanë shkuar te rruga për të kontrolluar se çfarë kishte ndodhur dhe ai e ka parë Valonin i cili ishte duke ulëritur. Dëshmitari e ka pyetur Valonin se çfarë kishte ndodhur dhe ai është përgjigjur: “O Zot. Ata më kanë rrahur. Unë nuk e di se a i kam vrarë ata”. Dëshmitari nuk ka parë mavijosje apo gjak në Valonin, e as nëse ai kishte revole. Sipas këtij dëshmitari Valoni është larguar me Memlin dhe Flamir Myftarin, vëllain e tij.

Katër persona kanë qenë dëshmitar të ngjarjes: Blerim Baliaj, Haki Hasani, Halil Rrahmani dhe Blerim Rrahmanaj.

Dëshmitari **Blerim Baliaj** ka dhënë deklarata përpara gjykatësit hetues, përpara trupit të mëparshëm gjykues<sup>12</sup> dhe përpara trupit aktual gjykues më 27 Prill 2010. Deklaratat e dëshmitarit nuk dallojnë përkundër distancës së kaluar kohore.

Gjatë seancës më 27 Prill 2010 dëshmitari ka deklaruar që më 8 Nëntor 2003, në fshatin e tij, ai është takuar me shokë dhe ata kanë vendosur që të shkojnë për të pirë kafe në Gjakovë. Kanë qenë katër persona në veturë – Hakiu, Halili, Blerimi dhe dëshmitari, i cili ishte i ulur në ulësen e prapme të pasagjerit. Shpejtësia e veturës ishte përafërsisht 70-80 km/h. Përderisa ata ishin duke lëvizur me veturë ai ka parë që katër njerëz kanë dalë nga një dyqan në rrugë dhe kanë filluar të rrihen në mes veti. Në moment të parë dëshmitari nuk i ka njohur se kush ishin ata njerëz, por kur vetura u afrua ai i ka njohur ata. Dy prej tyre ishin duke e grushtuar dhe goditur të akuzuarin me grushte. I katërti

---

<sup>9</sup> Ka dëshmuar përpara trupit gjykues më 19 Prill 2006

<sup>10</sup> Ka dëshmuar përpara trupit gjykues më 19 Prill 2006

<sup>11</sup> Ka dëshmuar më 24 Prill 2006

<sup>12</sup> Shih procesverbalin e 12 Prillit 2006

nuk ishte i përfshirë në rrahje dhe qëndronte më larg. Sipas dëshmitarit dy njerëzit të cilët rriheshin me Valonin ishin Sadiku dhe një njeri tjetër i ri emrin e të cilit dëshmitari nuk e di. Pasi që njerëzit ishin në rrugë, vetura në të cilën ishte dëshmitari u dashtë që të ngadalësojë shpejtësinë dhe të ndryshoj drejtimin për të mos i goditur ata. Po në momentin kur vetura ngadalësoi, dëshmitari ishte rreth 5 metra larg nga katër njerëzit dhe në atë moment ai i ka njohur ata. Përkundrazi ka qenë terr por dëshmitari ka mundur të shohë pasi që dritat e veturës ishin të ndezura dhe gjithashtu kishte edhe dritë që vinte nga dyqani, i cili ishte rreth 20 metra larg nga njerëzit që rriheshin. Vetura vazhdoi të lëviz në rrugë pasi që shokët e tij nuk e kuptuan që ishte një rrahje, por dëshmitari ka vazhduar të shikojë nga dritarja e prapme. Katër njerëzit rriheshin në dy grupe, dy me dy – Dadiku e rrihte Valonin, dhe dy të tjetër e godisnin njëri tjetrin (Sefedini dhe një person i katërt). Pastaj, personi i katërt u tërhoq dhe Sefedini iu bashkëngjiti Sadikut. Dy persona, Sadiku dhe Sefedini, e godisnin Valonin. Sipas dëshmitarit Valoni tentonte të ikte por dy njerëzit nuk e lejonin atë, ata e kapën atë. Ai ka parë që për shkak të goditjeve të pësuar Valoni ka rënë në tokë, dhe pastaj ai është ngritur përsëri dhe ka shtënë 5 apo 6 të shtëna. Të shtënat ishin kolektive, jo të ndara. I pyetur nga trupi gjyqësor dëshmitari ka përshkruar, dhe edhe ka demonstruar gjatë seancës, që Valoni kishte rënë në gjunjë, duke e prekur tokën me pëllëmbët e duarve, pastaj ai është ngritur dhe ka lëvizur pak prapa, dhe përderisa ende ishte poshtë por në momentin kur ngrihej, ai e ka nxjerrë revolen. Në atë moment Sadiku ka qenë shumë afër Valonit, në distancë prej gjysmë metri nga ai. Sefedini qëndronte një hap prapa Sadikut. Dëshmitari e ka dëgjuar Valonin duke i thënë Sadikut “Mos më u afro”. Por Sadiku ka tentuar që ta kapë revolen dhe Valoni, në një pozicë gjysmë në këmbë, ka shtënë në drejtim të trupit të Sadikut, dhe më saktësisht në drejtim të gjoksit të tij. Sadiku ka rënë në tokë. Dëshmitari ka dëgjuar rreth 5 të shtëna. Dritaret e veturës ishin të hapura dhe ai ka dëgjuar që Valoni ishte duke bërëtitur dhe që djali i ri (Sefedini) ishte duke ulëritur kur Sadiku është vrarë. Sipas dëshmitarit ai ka bërëtitur “Ti ma ke vrarë axhën!” Sefedini ka lëvizur kah Valoni dhe menjëherë pas kësaj Valoni ka shtënë në të. Distanca kohore në mes të shtënave të para dhe të dyta me gjasë ka qenë disa sekonda. Pas kësaj Valoni është larguar nga vendngjarja dhe ka shkuar në drejtim të shtëpisë së tij duke ulëritur dhe bërëtitur. Sipas dëshmitarit, personi i katërt ishte larguar nga vendngjarja para Valonit. Dëshmitari nuk e ka parë Valonin duke e mbushur

revolen e tij para se që ka shtënë. Dëshmitari e ka përshkruar Sadikun si më të vjetër se Valonin, pak më të gjatë se Valonin dhe pak më të plotë se ai. Pasi që ka parë se çfarë kishte ndodhur, dëshmitari ka insistuar që shokët e tij ta ndalin veturën. Ata kanë bërë një kthim me veturë rreth 100-150 larg, janë kthyer në vendngjarje, kanë kaluar pranë saj, kanë bërë edhe një kthim me veturë afër asaj dhe kanë ndaluar veturën. Sipas dëshmitarit, kur ata kanë e kanë kaluar vendngjarjes pasi që e kanë bërë kthimin e parë me veturë Sadiku dhe Sefedini tashmë ishin të vdekur. Dëshmitari dhe shokët e tij ishin të parët që arritën në vendngjarje. Pas tyre kanë ardhur njerëzit nga dyqanet.

**Dëshmitari Haki Hasani** ka konfirmuar në përgjithësi dëshminë e dëshmitarit Baliaj<sup>13</sup>. Ai ka deklaruar që ai ishte duke e ngarë veturën me 100-120km/h me drita të ndezura kur ata iu afruan vendngjarjes. Ai ka parë dy ose më shumë njerëz duke u rrahur, ai ka dëgjuar një apo dy të shtëna dhe dy njerëz duke hy në shtëpinë e Valonit. Sipas dëshmitarit njëri prej vëllezërve Jaha ka arritur i pari në atë vend dhe e ka thirrur policinë. Policia ka arritur gjysmë ore më vonë.

**Dëshmitari Halil Rrahmani** gjithashtu i ka konfirmuar deklaratat e dëshmitarit Baliaj<sup>14</sup>. Sipas tij, kanë qenë tre apo katër persona që rriheshin në rrugë. Dëshmitari ka dëgjuar disa të shtëna dhe e ka parë një person duke u rrëzuar; ai gjithashtu i ka parë dy njerëz duke ikur me vrap nga vendngjarja.

Dëshmitari **Blerim Rrahmanaj**<sup>15</sup> ka deklaruar që ai i ka parë tre apo katër persona duke e shtyrë njëri tjetrin dhe më vonë ai i ka parë dy persona duke vrapuar drejt një rruge lokale dhe duke u larguar nga vendngjarja.

#### **Pas vrasjes:**

**Dëshmitari Faton Aliaj**<sup>16</sup> ka deklaruar që ai ishte informuar për aksidentin nga stacioni i Policisë në Gjakovë. Ai e ka kontaktuar të akuzuarin me telefon mobil dhe ka vazhduar të flet me të derisa ka arritur në vendngjarje. Ora ka qenë në mes 17.30-17.45. Gjatë bisedës telefonike i akuzuari e ka pyetur dëshmitarin nëse personat që ai i ka qëlluar ishin gjallë apo të vdekur. Dëshmitari e ka gjetur të akuzuarin në fshatin Duzhnje, dhe ai ia ka

---

<sup>13</sup> Shih procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor më 24 Prill 2006

<sup>14</sup> Ai ka dhënë deklaratë përpara gjykatësit hetues më 12 Prill 2004 dhe përpara policisë më 14 Nëntor 2003

<sup>15</sup> Ka dhënë deklaratë përpara policisë më 14 Nëntor 2003

<sup>16</sup> Shqyrtimi gjyqësor më 3 Maj 2006

atij armën vullnetarisht. Sipas dëshmitarit i akuzuari ishte duke qarë. Në atë kohë Valoni ka qenë me kushëririn e tij Memli Myftari.

**Dëshmitari Riza Rexhepi**<sup>17</sup>, oficer i Policisë së Kosovës, deklaroi se ai ishte në njësinë që bëri inspektimin fillestar të vendit të ngjarjes në 8 Nëntor 2003. Ata gjetën katër gëzhoja të kalibrit 9 mm, një fishek të të njëjtit kalibër, një plumb 9 mm dhe një pjesë të veshjes së plumbit. Të nesërmen u gjendën gëzhoja të tjera, por ai nuk ishte i pranishëm.

**Dëshmitari Skender Sadriu**<sup>18</sup>, xhaxhai i të pandehurit, tha se ai e pa dhe foli me Valonin pas vrasjeve. Ishte rreth orës 21:00. Në atë kohë Valoni u dërgua nga stacioni policisë në spital. Sipas dëshmitarit, Valoni ishte i plagosur, i gjithë trupi, duart e tij ishin mbuluar me gjak, ai kishte mavijosje pas kokës dhe pantallonat i kishte të grisura. Ai po qante dhe dukej si në fotografitë 1 - 4<sup>19</sup>.

#### Dëshmia e të pandehurit Valon Myftari

**I pandehuri** dha disa herë dëshmi përpara gjyqtarit hetues, përpara trupit të mëparshëm gjykues si dhe përpara trupit gjykues të tanishëm.

Në seancën dëgjimore të 28 Prillit 2010 ai deklaroi se gjatë ditës kritike ai nuk ishte në shërbim por ndihmoi kolegët e tij të Policisë së Kosovës për të gjetur vendodhjen e automjetit të vjedhur në rajonin e Pejës. Pas kësaj, duke u kthyer për në shtëpi, ai ndaloi tek shitorja e Sahit Bajramit për të blerë një pjesë ndërrimi për automjetin e kolegut të tij Bekim. Shtëpia e tij ishte rreth 150 metra larg shitores. 10 metra larg shitores ai takoi Sadikun dhe Sefedinin që e ndaluan atë. Sadiku i tha atij “përse i fut hundët në punët e mija, shih punët e tua, përse i jep informacion të tjerëve për mua”. Dhe ai ju afrua Valonit. Sadiku kishte dorën tek kofsha, dhe po ashtu edhe Valoni, ai e vuri dorën tek arma. Sadiku ju afrua Valonit dhe u përpoq t’ia merrte armën. Sadiku rrëmbeu armën dhe e vuri gishtin në këmbëz. Valoni arriti ta marrë përsëri armën dhe më pas mori një goditje nga prapa. Valoni u përpoq që të largohej por ata nuk e lejuan dhe vazhduan ta godisnin. Sadiku ishte nga ana e tij e majtë dhe Sefedini nga e djathta. Valoni u largua rreth 10 metra që aty dhe arriti në rrugën kryesore. Valoni e mbushi armën në grykë dhe i tha atyre, “mos e bëni këtë, unë jam oficer policie dhe fishekët janë brënda”. Sadiku i tha

---

<sup>17</sup> Dëshmoi në 21 Prill 2006

<sup>18</sup> Gjykimi kryesor në 3 Maj 2006

<sup>19</sup> Prova dokumentare të datës 4 Mars 2004

Sefedinit “ai gënjen, merrja armën”. Valon tërhoqi këmbëzën e armës. Ai e pa veten të paaftë të luftonte me ta se ata ishin më të fortë; ai vetëm po përpiquej të largohej nga ata. Për shkak të goditjeve të marra ai ra në gjunjë, me pëllëmbën e majtë dhe bërrylin e djathtë në tokë. Në atë moment atij ju humbi vetëdijen për shkak të një goditje të fortë dhe po humbte fuqinë. Dhe në këtë pozicion ndërsa po përpiquej të ngrihej ai shtiu plumbin e parë. Sipas të akuzuarit, Sefedini ishte sipër tij dhe Sadiku ishte nga a e majta e tij. Kur Valoni u përpoq që të ngrihej, Sadiku mbërtheu krahun e tij të majtë në pjesën sipër bërrylit, dhe në atë moment Valoni shtiu. Sipas të akuzuarit ai ishte me gjunjë në tokë me pëllëmbën e tij ta majtë në tokë, ai shtiu me dorën e djathtë, në drejtim të anës së tij të majtë dhe drejtimi ishte nga poshtë lart. Ai po shtinte në momentin që ai po ngrihej. Kur po shtinte pozita e armës së tij ishte afër veshit të tij të majtë, më pas ai e çoi armën përpara ballit të tij, gjithashtu duke shkuar nga e majta në të djathtë. Sipas tij ai nuk kishte synim që të qëllonte ndonjë, por thjesht donte të ndalonte sulmin sepse jeta e tij ishte kërcënuar dhe ai po humbte forcat. Gjithashtu sipas të akuzuarit, ai shtiu tre herë dhe më pas humbi vetëdijen. Ai shtiu deri sa ndjeu që askush nuk po e prekte më atë. Pas kësaj ai kujton që filloi të shkante por pa e ditur se ku, ai ishte i frikësuar se mos ishin dhe të tjerë përqark, meqë nuk e kishte parë se kush e godiste atë nga pas. Kur arriti në shtëpi ai lajmëroi policinë se kishte qëlluar me armë por ai nuk e dinte në atë moment nëse kishte plagosur apo kishte vrarë ndonjë. Më vonë, atij i thanë në stacionin e policisë se ai vrau Sadikun dhe Sefedinin. I akuzuari nuk e dëgjoji Sefedinin ti thonte atij, “ma vrave axhën”, në fakt e fundit gjë që ai dëgjoji përpara se të qëllonte ishte kur Sadiku i tha Sefedinit, “mbërtheja atë, mbërtheja atë, ai po të gënjen”.

Ballafaquar me dëshminë që i akuzuari dha përpara gjyqtarit hetues për pozitën që ai ishte kur qëlloi dhe për dijeninë e tij se cilin qëlloi, i akuzuari konfirmoi se version që ai dha në gjykimin kryesor në 28 Prill 2010 ishte ai i sakti. Përvec kësaj i pandehuri shtoi se dy muaj përpara ngjarjes një koleg i tij, Hajdar Ahmeti, ishte vrarë.

Sipas të akuzuarit nuk ka patur një person të katërt në vendin e ngjarjes.

I akuzuari konfirmoi se ai mbështeste deklaratën e tij të dhënë përpara këtij trupi gjykues. Përpara gjyqtarit hetues ai spjegoi vlerësimin e tij për arsyet e sulmit të Sadikut dhe Sefedinit ndaj tij. Ai spjegoi se gjatë luftës në 1998-1999 Sadiku strehoi në shtëpinë e tij Valonin për dy-tre javë. Sadiku ishte përfshirë me UCK. Madheniet e tyre mbetën

miqësore deri në vrasjen e oficerit të policisë së Kosovës Hajdar Ahmeti në 6 Shtator 2003. Valoni i dha disa informata hetuesve të Policisë së Kosovës për shokët dhe bashkëpuntorët e Sadikut dhe Sefedinit. Menjëherë pas kësaj, afërsisht një muaj përpara 8 Nëntorit 2003 Valonin e ndoqën dhe e ruajtën shokët e Sadikut dhe ai kishte frikë për jetën dhe sigurinë e tij.

### **Faktet e padiskutueshme**

Faktet e mëposhtme nuk janë kundërshtuar nga i akuzuari dhe trupi gjykues është i bindur se ka ndodhur si më poshtë:

I akuzuari në kohën e incidentit ka qenë oficer i Policisë së Kosovës. Ai nuk ishte në detyrë, ishte i veshur me rroba sportive dhe kishte me vete armën pistoletë

Glock kalibër 9x19. I akuzuari nuk vë në diskutim faktin se si rezultat i të shtënave të tij ndaj dy viktimave me pistoletën e tij zyrtare u qëlluan për vdekje Sadik Zeneli dhe Sefedin Zeneli. Kjo ndodhi në 8 Nëntor 2003, rreth orës 17:00 në fshatin Duizhnje, komuna e Gjakovës.

Sipas ekspertëve **Dr. Morcillo dhe Dr. Gazior**, eksperte patologë, Sadik Zeneli ka marrë pesë plagë, një në faqe, një në kokë, një në toraks, një në abdomen dhe një në parakrahun e djathtë. Ai vdiq menjëherë pasi ishte qëlluar, vdekja e shkaktuar nga plaga në tru (dy të shtëna goditën kokën). Një nga këto të shtëna ishte bërë në një distancë e afërt duke përjashtuar një plagë kontakti. Plaga në toraks nuk ishte vdekjeprurëse menjëherë, dhe nëse personit do ti ishte dhënë një trajtim i duhur mjeksor, ai mund të kishte mbijetuar. Plumbi i katërt i ka hyrë në abdomen, ka dalë nga pjesa e poshtme e murit të abdomenit dhe ka rihyrë përsëri në pjesën e poshtme të anës së majtë të murit të abdomenit. Kjo nuk shkaktoi plagosje vdekjeprurëse. Plumbi i pestë goditi parakrahun e djathtë dhe nuk shkaktoi plagosje në organet vitale.

Sefedin Zeneli mori dy plumba; njëri hyri në faqe nëpërmjet flegrës së majtë të hundës dhe një në parakrahun e tij të majtë. E shtëna në faqe shkaktoi një plagosje në vrimën e gojës me një gjakderdhje të menjëhershme në rrugët e kalimit të ajrit duke shkaktuar kështu vdekjen e viktimës nga mosfunksionimi akut i frymëmarrjes. Viktima nuk vdiq menjëherë pas të shtënës por pak kohë pas saj. Sipas ekspertëve **Dr. Gazior**<sup>20</sup> dhe

---

<sup>20</sup> Shih procesverbalin e 8 Majit 2006

Matthias Fell <sup>21</sup> për sa i përket plagosjes në kokë, arma është shkrepur nga një distancë shumë e afërt me viktimën, distance midis armës dhe viktimës ishte më pak se 30 cm, por pa e prekur drejtpërsëdrejti (plagë kontakti).

Sadik Zeneli ishte 59 vjeçar, peshë 90 kg dhe gjatësi 177 cm.

Sefedin Zeneli ishte 29 vjeçar, peshë 80 kg dhe gjatësi 180 cm.

Përvec kësaj **Matthias Fell**<sup>22</sup>, një oficer policie Gjerman që kreu egzaminimin balistik, deklaroi përpara trupit të mëparshëm gjykues se arma e përdorur nga i akuzuari ka karakteristika sigurie automatike, që janë këmbëza dhe siguresa që është siguresa e këmbëzës. Siguresa duhet të shtyhet tërësisht me një gisht, dhe vetëm duke vepruar kështu, atëhere këmbëza mund të tërhiqet për të hapur zjarr. Gjilpëra e goditëse është e kycur brënda shulit. Për të qëlluar dikush duhet të vendosë gishtin në këmbëz, dhe pastaj gishti e shtyn prapa siguresën. Më pas këmbëza duhet të shkojë prapa. Kur këmbëza shkon tërësisht prapa pjesa metalike ngreh siguresën e gjilpërsës për të shtënë. Pasi është kryer e shtëna e parë, shtrati shulit shkon prapa, nxjerrësi e nxjerr jashtë gëzhjojën, dhe automatikisht e rimbush me plumbin tjetër. Në këtë moment arma është në të njëjtën pozitë të sigurisë si në të shtënë e parë. Për të kryer një të shtënë tjetër duhet të kalohet përmes së njëjtës procedurë që është përshkruar më lart. Kjo do të thotë që arma nuk mund të qëllonte automatikisht, por për cdo të shtënë ai duhet që të kryente të njëjtën procedurë që të çkyçte elementët siguries.

Eksperti nuk mund të gjejë se cilët ishin pozicionet e viktimave dhe të akuzuarit në momentin e goditjes.

Sipas raportit të kriminalistikës së kryer nga Instituti Kërkimor i Forensikës në Bullgari, ekspertët Dimitar Duimitrov dhe Ivanka Vassileva (protokol No39) gjetën se sipas gjurmëve në teshat e Sadikut dhe Sefedinit, të shtënat ishin kryer nga një distancë më e madhe se 40 cm.

Sipas raportit kriminal të përgatitur nga Riza Rexhepi në 8 Nëntor 2003 në vendin e ngjarjes u gjetën 4 gëzhjoja të kalibrit 9x19mm, një fishek i të njëjtit kalibër, një plumb dhe një pjesë e plumbit, të gjitha të njëjtit kalibër. Sipas dëshmitarit Rexhepi në karrikatorin e armës së të akuzuarit u gjetën 23 municione të pashkrehura maksimumi i

---

<sup>21</sup> Shih procesverbalin e 8 Majit 2006, faqe 11 dhe 12

<sup>22</sup> Deklaratë e dhënë në 15 Mars 2005 përpara gjyqtarit hetues, në 8 maj 2006 në gjykimin kryesor

municioneve që mund të mbaje arma është 30. Cdo karrikator ka 15 plumba. Cdo oficer policie merr gjatë detyrës dy karrikatorë.

Sipas raportit mjeksor të repartit të urgjencës së spitalit të Pejës, pas incidentit i akuzuari u gjet me gërvishje dhe skuqje në qafë, në shpinë dhe një gërvishje në gishtin e madh të dorës së djathtë dhe në të dy gjunjët.

Sipas panelit të ekspertëve që kryen egzaminimin psikiatrik të akuzuarit, **Dr Nazmie Idishi-Musliu (psikiatre), Dr. Shaban Mecinaj dhe Mr.sc. Nada Morina (pathologë klinikë)** Valon Myftari nuk ka pësuar dhe nuk vuan ndonjë çrregullim të përkohshëm apo të përhershëm të cilësisë psikotike, dëmtim organik cerebral, varësi të alkoholit apo të ndonjë substance tjetër. Nuk ka ndonjë gjë të pazakontë në zhvillimin e tij intelektual. Ekspertët nuk gjetën ndonjë çrregullim apo manifestim të simptomave të psikopathologjisë që si rezultat i intesitetit dhe natyrës do të ndikonte në aftësinë e tij mendore për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij në momentin e veprës penale. Sipas Dr. Morina <sup>23</sup> humbja e vetëdijes është e karakterit apo natyrës emocionale dhe nuk përfundon apo prish funksionimin mendor, dhe në këtë mënyrë nuk redukton aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar funksionet e tij/saj. Megjithatë ekspertët deklarojnë se Valon Myftari veproi në një gjendje shumë emocionale. Përsëri ata nuk mund të konfirmojnë nëse ai ka humbur apo jo vetëdijen meqenëse kjo varet nga aspekti personal dhe emocional i personit. Por humbja e vetëdijes nuk ndikon në funksionimin e gjendjes mendore për të marrë vendime dhe kontrolluar vullnetin e tij. Sipas Dr. Morinës në momentin që Valoni shtiu mbi viktimat atë e kishte pushtuar frika dhe pasiguria për gjendjen e tij fizike, por ai nuk ishte në gjendje të stresit mendor apo tronditjes. Dy ekspertët e tjerë Dr Nazmie Idishi-Musliu dhe Dr Nazmie Idishi-Musliu mbështesin këtë mendim dhe qartësojnë se gjendja e rëndë emocionale e të akuzuarit nuk ka ndikuar në aftësinë e tij mendore në atë masë që të humbë kontrollin e gjykimit për veprimet e tij. Po ashtu gjendja emocionale e të akuzuarit pas vrasjes së parë nuk ndryshoi deri në vrasjen e dytë.

## **Vlerësimi i fakteve dhe konkluzioneve ligjore**

---

<sup>23</sup> Shih procesverbalin e gjykimit kryesor në 20 Maj 2010

Pas prezantimit të dëshmime dhe deklaratave të mësipërme, për rindërtimin faktik të ngjarjes që ndodhi në ditën kritike të 8 Nëntorit 2003, mund të konsiderohen të provuara dhe të pa dyshimta pikat e mëposhtme, bazuar në auptosinë, inspektimin e vendit të ngjarjes, dëshmime të dëshmitarëve dhe ekspertëve dëshmitarë dhe pranimi nga i pandehuri:

Në 8 Nëntor 2003 Valon Myftari qëlloi Sadik Zenelin me pesë të shtëna dhe Sefedini Zenelin me dy të shtëna. Te dy viktimat vdiqën si rezultat i të shtënave. Sadiku mori dy plagë në kokë, se plaga në pjesën e përparme ishte shkaktuar nga një distancë shumë e afërt, një në toraks, një në abdomen dhe një në parakrahun e djathtë. Dy nga të shtënat janë qëlluar nga pjesa e prapme në pjesën e përparme dhe të tjerat nga pjesa e përparme në të mbrapmen. Sefedini mori dy plagë – një midis flegrës së hundës dhe buzës, shumë e afërt, marrë nga përpara në pjesën e prapme, dhe kjo ishte plaga që shkaktoi vdekjen e tij, e shtëna e dytë është në parakrahun e tij të majtë nga e majta në të djathtë.

Valoni pati dëmtime gjithashtu – gërvishje dhe skuqje të qafës, shpinës, një gërvishje në gishtin e madh të dorës së djathtë dhe në të dyja gjunjët.

Kështu që, në bazë të rrethanave të mësipërme, është çështje e vlerësimit nëse i pandehuri veproi në Mbrojtje të Nevojshme apo, në të kundërt, kreu veprën penale të vrasjes së provokuar, në shkelje të Nenit 33 të LPK, apo kreu veprën penale të Vrasjes, në shkelje të Nenit 30 të LPK<sup>24</sup>.

Sigurisht, për të bërë një vlerësim ashtu sic duhet, është e nevojshme të rindërtohet në tërësi veprimet e të pandehurit dhe viktimave.

Plagosjet e viktimave dhe të pandehurit tregojnë që ka patur një përleshje midis Valonit, Sadikut dhe Sefedinit, dhe se ka patur një kontakt direkt midis atyre të treve – Valoni është goditur me grushta dhe shkelma, dhe gërvishjet në të dy gjunjët e tij tregojnë se ai ishte në atë pozicion kur u rrëzua në gjunjë. Kjo situatë përputhet me dëshmitë e Blerim Baliajt. Në fakt Blerim Baliaj është i vetmi dëshmitar okular që pa përleshjen që nga fillimi deri në fund. Trupi gjykues vlerëson që ky dëshmitar është i besueshëm. Ai i njihnte viktimat dhe të pandehurin meqë ata jetonin afër atij. Nuk ka prova (dokumenta apo deklaratat të paraqitura) që tregojnë praninë e arsyeve të mëparshme të urrejtjes apo

---

<sup>24</sup> Dispozitat e mësipërme të LPK janë më të favorshme se sa dispozitat korresponduese të KPK, kështu që të mëparshmet janë ato të zbatueshmet.

armiqësisë midis këtij dëshmitari dhe të pandehurit, ose egzistencën e fakteve të tjera apo rrethanave që mund të përbënin një arsye të mjaftueshme për këtë arsye që të akuzonte të pandehurin në mënyrë të rreme për një krim kaq të rëndë. Tregimi i tij është në brendësi koherent dhe llogjik dhe në përputhje të plotë me konkluzionet dhe raportet e ekspertëve. Dëshmitari kishte mundësinë ta shihte përleshjen nga një distancë e afërt – ai filloi ta shihte skenën kur përleshja sapo filloi dhe në momentin kur është qëlluar Sadiku, automjeti ku ai qëndronte i ulur në ndenjësën e prapme ishte shumë pranë vendit të ngjarjes. Që të mos i godiste ata, automjeti pothuajse u ndal dhe më pas vazhdoi të lëvizë por me shpejtësi shumë të ngadaltë. Dhe më pas u kthye dhe kaloi pranë vendit të ngjarjes për herë të dytë. Ishte rreth orës 17:00 në Nëntor, ishte errësirë, kohë e vrënjtur por ende e dukshme. Përveç kësaj dritat e automjetit ishin të ndezura dhe kishte dhe drita që vinin nga shitoret aty pranë. Dëshmitari është një djalë i ri, atëherë ai ishte vetëm 21 vjeç dhe gjendja e tij fizike nuk jep as më të voglin tregues për trupin gjykues që ai të mos ketë qenë në gjendje të shihte qartë, të kujtonte faktet dhe ti raportonte ato sic duhej. Të gjithë dëshmitë që ai ka dhënë janë të përputhshme me njëra tjetrën, pavarësisht nga periudha kohore që ka kaluar. Fakti që ky dëshmitar ishte akuzuar për një vepër penale nuk e bën atë të pabesueshëm lidhur me këtë ngjarje. Ai ka bashkëpunuar plotësisht me gjykatën dhe ka dhënë dëshmi disa herë<sup>25</sup>.

Dëshmitë e tij ndryshojnë me pranimin e të pandehurit. Sipas të pandehurit ai vrau fillimisht Sefedinin që ishte sipër tij dhe më pas vrau Sadikun, por pas të shtënës së dytë ndaj Sadikut ai humbi vetëdijen. Sipas dëshmitarit, Valoni vrau fillimisht Sadikun i cili u përpoq t'ja rrëmbetnte armën, dhe më pas Sefedinin i cili në atë moment po rrinte pas Sadikut por që pas vdekjes së tij shkoi tek Valoni dhe Valoni e vrau atë. Duke parë plagët e të dy viktimave, gjykata i jep besim dëshmive të dëshmitarit Blerim Baliaj dhe konsideron që përshkrimi i tij i fakteve vërteton konkluzionet e tjera të nxjerra në gjykim, që janë, deklaratat e dëshmitarëve dhe raporteve të ekspertëve. Sadiku është qëlluar në kokë nga pjesa e përparme në të mbrapmen dhe trajektoria anatomike e plumbit është pak nga sipër. Kjo do të thotë që arma ishte në pozicion pak më të lartë në momentin e të shtimes. I akuzuari u përpoq të spjegonte se kur u përpoq të ngrihej, Sadiku i mbërtheu

---

<sup>25</sup> Ai dha dëshmi përpara trupit gjykues të gjykimin të fundit dhe ju përgjigj pyetjeve për më tepër se gjashtë orë.

krahun e tij të majtë në pjesën sipër bërrylit, dhe në atë moment Valoni shtiu. Ky version është pak i pa pëpërputshëm, sepse në atë mënyrë trajektori e goditjes së Sadikut do të ishte në një pozicion më të ulët dhe të shtënës do të ishin në drejtimin nga e majta në të djathtë. Sadiku ishte më i gjatë se Valoni dhe në momentin e shtënës së parë ai ishte në një pozicion pak më poshtë se Valoni. Pas të shtënës së parë Sefedini ndryshoi pozicionin meqenëse plagët janë në vende të ndryshme të trupit si dhe në anë të ndryshme – prapa dhe përpara. Ka shumë mundësi që trupi i tij lëvizti në drejtim sikur po binte nga lart poshtë dhe kështu ai mori plumbat në abdomen, që kishte dy vrima hyrëse, dhe pas kësaj dy të shtëna nga prapa – në kokë dhe në gjoks.

Sipas të pandehurit ai e qëllloi Sadikun ndërsa Sefedini ishte mbi të. Përvec kësaj ai spjegoi se e qëlloi atë ndërsa qëndronte në gjunjë. Duke patur parasysht faktin që Sefedini ishte më i gjatë se Valoni, më i rëndë se ai, është pak e mundshme që Valoni të ketë mundur të çohet mbi Sadikun dhe ta qëllonte pesë herë atë dhe të shtinte mbi Sefedinin që ishte ende sipër tij. Përvec kësaj, trajektoria e plagës në kokën e Sefedinit tregon se plumbi ka shkuar horizontalisht në fytyrën e tij, kështu që niveli i armës ishte në pozicion horizontal dhe drejtëpërdrejtë në fytyrë, pak nga poshtë lart dhe nga e djathta në të majtë. Nëse Sefedini do të ishte në shpinë të Valonit atëherë goditja në kokë do të kishte një trajektore të ndryshme. Kjo trajektore e bindi trupin gjykues të pranojë variantin e dëshmitarit Baliaj që Valoni e qëlloi Sefedinin pasi ai qëlloi Sadikun në pozicionin kur Sefedini po i afrohej Valonit duke bërë titur “Ti ma vrave axhën”. Distanca e armës nga Sefedini ishte shumë e afërt, meqenëse sipas ekspertëve goditja në fytyrë është bërë nga më pak se 40 cm larg. Trupi gjykues pranoi se Valoni e qëlloi Sefedinin në fytyrë në momentin e fundit përpara se Sefedini ta arrinte atë. Kjo do të thotë po ashtu që Sefedini po e sulmonte Valonin. Është shumë e mundshme që Sefedini të jetë qëlluar në krah kur ai po sulmonte Valonin dhe përpara se ai të qëllonte në kokë. Trajektoria e këtij plumbi tregon se Sefedini ka shumë mundësi të ketë ngritur krahun në një pozicion sulmi. Kjo plagë është marrë nga një distancë jo shumë e afërt. Konkluzioni llogjik është se Sefedini po i afrohej Valonit, pasi u qëllua axha i tij, në mënyrë sulmuese. Valoni shtiu një herë nga Sefedinit dhe e goditi në krah. Sefedini nuk ndaloi, ju afrua Valonit dhe nga një distancë shumë e afërt Valoni e qëlloi atë në kokë.

Pas vlerësimit se si ishte situata faktike, duhet të vlerësohet nëse sjellia e të pandehurit mund të përshkruhet si një veprim i Mbrojties së Nevojshme.

Së pari, për këtë ceshtje, meqenëse krimi është kryer kur ishte në fuqi LPK (1977), dhe më vonë në 2004 hyri në fuqi KPP, duhet të përcaktohet se cila dispozitë që lidhet me Mbrojtien e Nevojshme është më e favorshme. Për të qartësuar më mirë duhet të përmendet që LPK (1977) nuk përfshin pjesën e përgjithshme dhe prandaj sipas Nenit 7 të KP të RFSJ (1977) dispozitat e pjesës së përgjithshme të KP të RFSJ ishin të zbatueshme gjithashtu për veprat penale përcaktuar në ligjet e Kosovës, si një province socialiste autonome. Mbrojtia e Nevojshme ishte e rregulluar nga KP i RFSJ, Neni 9 dhe jo nga LPK. Mbrojtia e nevojshme është një institut i rregulluar në Nenin 8 të KPK.

Midis të dy dispozitave, neni 9 të KP të RFSJ dhe Neni 8 të KPK, që duhen vlerësuar jo *in abstracto*, por në lidhje me zbatimin konkret të lëndës, më i favorshëm duket të jetë Neni 9 i KP të RFSJ meqenëse nuk kërkohet që sulmi të jetë real dhe i prishëm, si dhe nuk kërkon që të jetë proporcional, që në fakt janë parashikuar në Nenin 8 të LPK. Përveç kësaj Neni 9 paragrafi 4 i KKP të drejton te Neni 147 (paragrafi 11) për sa i përket ndëshkimit për vrasjen e dy ose më shumë personave – së paku 10 vjet burgim ose burgim afat gjatë. Neni 30 i LPK (1977) parashikon për disa vrasje një dënim me së paku 10 vjet deri në 40 vjet burgim.

Sipas Nenit 9 të KP të RFSJ, një akt është kryer në Mbrojtie të Nevojshme kur është **absolutisht e nevojshme për kryerësin e veprës penale të shmangë një sulm të menjëhershëm të paligjshëm ndaj tij apo një personi tjetër.**

Është e padiskutueshme që sulmi i viktimave kundër të pandehurit ishte i paligjshëm, sepse ishte në disproporcion (momentin personi i katërt u largua nga përleshja, Sadiku dhe Sefedini të dy filluan ta rrihnin Valonin, që ishte i vetëm, me grushte dhe me shkelma). Sulmi ishte i menjëhershëm, dhe është e qartë që i pandehuri nuk e priste. Ndodhi menjëherë pasi Valoni doli nga shitorja, nuk ishte e planifikuar nga Valoni që rastisi të ishte në atë vend. Sulmi nga dy viktimat ishte real, i drejtuar ndaj trupit dhe jetës së tij. Sadiku donte që t'ja merrte armën dhe ta qëllonte<sup>26</sup>. Valon u përpoq që ti rezistonte sulmit duke u larguar, por gjithashtu goditur Sadikun dhe Sefedinin, duke i treguar armën viktimave dhe në këtë mënyrë duke i kërcënuar ata që ti ndalonte, duke rimarrë armën e

---

<sup>26</sup> Shih deklaratën e dëshmitarit Baliaj dhe atë të pandehurit

tij përsëri, kur Sadiku u përpoq që t'ja merrte dhe ja drejtoi atij armën. Në fund kur Valoni u rrah dhe ra përtokë në gjunjë, që dukej qartë që ai ndjehej shumë i pafuqishëm, ai vendosi të përdorë armën dhe të mbronte veten. Sipas tij, nëse ai nuk do ta kishte përdorur atë, tani ai do të ishte i vdekur. Edhe përpara se të përdorte armën ai e paralajmëroi Sadikun që të ndalonte sulmin; përndryshe ai do të përdorte armën<sup>27</sup>. Pandjeshmëria dhe numri i të shtënave ndaj Sadikut teqojnë se Valoni kishte qëllim të ndalonte sulmin e Sadikut. Në rast se do të kishte qëllim ta vriste atë ai ndoshta do të kishte përdorur një apo dy të shtëna dhe jo pesë duke e goditur atë në pjesë të ndryshme të trupit. Pandjeshmëria gjatë të shtënave tregojnë gjithashtu frikën dhe gjendjen e vecantë mendore. Trupi gjykues vlerëson se në atë moment, kur Valoni qëllloi Sadikun, mënyra se si reagoi në mbrojtje ishte absolutisht e nevojshme për të shmangur sulmin e Sadikut dhe Sefedinit. Integriteti trupor dhe jeta e Valonit u kërcënuan. Nëse ai nuk do të kishte shtënë ndaj Sadikut, ai ka shumë mundësi të ishte vrarë (Sadiku u përpoq që t'ja merrte armën). Ishte mbrojtje e nevojshme. Sipas Nenit 9 të KP të RFSJ një vepër e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe në këtë mënyrë përgjegjësia penale është përjashtuar. Sipas Nenit 390 i.1 të KPPK i akuzuari duhet të lirohet nëse vepra me të cilën është ngarkuar nuk përbën një vepër penale.

Pasi ishte vrarë Sadiku, Sefedini i bërtiti Valonit, “më vrave axhën dhe u hodh në sulm ndaj Valonit. Në atë moment, duke e parë që Sefedini po i afrohej atij në mënyrë sulmuese, Valoni shtiu dy herë. Goditja në kokë u krye nga një distancë shumë e afërt. Duke vlerësuar serinë e dytë e të shtënave ndaj Sefedinit, trupi gjykues konsideron se Valoni i tejkaloi kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Mbrojtia që a ndërmori duke shtënë dy herë ndaj Sefedinit nuk ishte më absolutisht e nevojshme për të shmangur sulmin e paligjshëm ndaj tij. Tani ata ishin një kundër një. Është e vërtetë që Valoni ishte më i lodhur se Sefedini, sepse pak momente më parë po ndeshej kundër dy sulmuesve. Dhe kështu që ai ishte në disavantazh. Ai po ashtu e dinte se meqenëse Sefedini pa vdekjen e axhës së tij ai do të donte po ashtu ta shihte Valonin të vdekur, pra do të donte të hakmerrej. Valoni ishte i zemëruar nga sulmi, ai po ashtu ndjeu një frikë shumë të madhe, por kjo nuk e pengonte aftësinë e tij për të kuptuar dhe marrë vendime. Konkluzioni i

---

<sup>27</sup> Dëshmitari Baliajdëgjoi Valonit ti thoshte Sadikut “Mos mu afro”. Por Sadiku u përpoq ti rrëmbente armën dhe Valoni, në pozicion gjysmë në këmbë, shtiu në drejtim të trupit të Sadikut, dhe më konkretisht në drejtim të gjoksit të tij. Sadiku ra përtokë. Dëshmitari dëgjoi rreth 5 të shtëna.

panelit të ekspertëve psikiatër është gjithashtu në këtë kuptim. Duke patur përpara vetëm kryerësin e veprës penale ai mund ta kishte shmangur vrasjen si mënyra për të shmangur sulmin. Trupi gjykues është i mendimit që Valoni mund ta kishte qëlluar atë diku në vend tjetër, në ndonjë pjesë tjetër të trupi jo vitale, duke mënjanuar vdekjen e tij, ose ai mund të ishte ndeshur, ose larguar. Megjithëse oficer i ri policie ai kishte tre vjet eksperiencë profesionale, ai kishte marrë disa tranime, megjithëse jo të mjaftueshme, në fushën e vetëmbrojtjes<sup>28</sup>. Megjithëse ishte shumë i trembur për jetën e tij duke patur vetëm një sulmues përpara tij dhe duke qenë oficer policie ai mund ti kishte rezistuar sulmit të tij pa e vrarë atë. Në këtë situatë i akuzuari duhet mbahet përgjegjës për kryerjen e veprës penale të vrasjes, por ndëshkimi i tij mund të lehtësohet (Neni 9 par.3 i KP të RFSJ).

Sipas pjesës së dytë të nenit 9 paragrafi 3 të KP të RFSJ nëse një kryerës i veprës i tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, kjo mund të përmbajë nga caktimi i dënimit ndaj tij.

Trupi gjykues nuk mund ta pranojë që tejkalimi ndodhi për shkak të tronditjes apo frikës së shkaktuar nga sulmi dhe në këtë mënyrë dënimi i të akuzuarit nuk mund të falet. Në jurisprudencë është pranuar që tronditja e madhe është një gjendje e vecantë emocionale që karakterizohet nga intensitet i madh i tronditjes dhe zemërimit, por me këtë rast nuk përjashtohet aftësia për të kuptuar dhe marrë vendime. Gjendja e frikës është një ndjenjë e frikës së madhe për shkak të mundësisë se një kategori e caktuar mund të shkelet<sup>29</sup>. Valoni nuk ishte në gjendje të tronditjes së fortë apo frikës. Sa për frikën për jetën e tij, pas vrasjes së Sadikut, ai kishte përpara tij një sulmues, ai kishte një armë dhe mjaft plumba, kështu që nuk ka opsione që do ta bindnin trupin gjykues se ai ishte i frikësuar për jetën e tij në atë gjendje të frikës.

Së fundi, mund të konkludohet se i pandehuri kishte kryer dy vrasje. Për vrasjen e Sadik Zenelit ai duhej të lirohej nga akuza në bazë të Nenit 9 paragrafi 1 të LP të RFSJ. Për vrasjen e Sefedinit ai duhej të gjendet fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes duke tejkeluar kufijtë e vetëmbrojtjes së nevojshme në shkelje të Nenit 30 paragrafi 3 dhe paragrafi 1 të Ligjit Penal të Provincës Autonome Socialiste të Kosovës e ndryshuar me

---

<sup>28</sup> see also his statements

<sup>29</sup> see commentary of the CC of FRY, Ljubisa Lazarevic

rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 dhe më pas e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, e dënueshme me së paku 10 vjet deri 40 vjet burgim.

### **Përcaktimi i dënimit**

Kur caktohet sanksioni penal, gjykata duhet të mbajë parasysh të dy qëllimet e përgjithshme të dënimit – që të ndalë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke frenuar të tjerët në kryerjen e veprave penale të ngjashme – dhe qëllimi specifik për të parandaluar kryerësin e veprës penale që të përsërisë kryerjen e veprës.

Sipas Nenit 41 paragrafi 1 i LP të RFSJ, gjykata duhet të marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe në vecanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e krimit, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjellia e mëparshme e kryerësit të veprës, gjendja e tij personale dhe sjellia e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit të veprës penale.

Si rrethana lehtësuese, trupi gjykues konsideroi bashkëpunimin e të akuzuarit për hetimin dhe pendimin e tij gjatë të gjithë procedurës gjyqësore, e gjitha kjo ndodhi kur ishin vrarë oficerë policie, vecanërisht një koleg i Valonit ishte vrarë kohët e fundit dhe ai dyshonte që Sadiku ishte përfshirë në të. Përvec kësaj Valoni i dha informata policisë për këtë çështje dhe ai ndjente që ndiqej nga Sadiku. Është një fakt i njohur se në atë kohë cdo burrë në Kosovë mbante me vetë armë. Sa për motivin e kryerjes së veprës penale, duket që të jetë vetëm të shmangte sulmin dhe mbronte jetën e tij. Prandaj ai u largua menjëherë pasi qëllloi Sefedinin, duke mos qenë i sigurtë nëse i kishte vrarë viktimat apo jo. Në këtë aspekt sjellia e Valonit pas vrasjes<sup>30</sup> nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese.

Po ashtu sjellia e mëtejshme e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale është tërësisht në favor të pandehurit. Ai u soll në mënyrë korrekte gjatë hetimeve dhe gjykimit kryesor, duke treguar shenjat e pendimit që kishte vrarë dy persona.

Procedura e gjatë penale kundër të pandehurit duhet të konsiderohet gjithashtu si rrethanë lehtësuese.

Trupi gjykues nuk mund të konsiderojë ndonjë rrethanë rënduese.

---

<sup>30</sup> Largimi nga vendi i krimit dhe mos kujdesja për viktimat, Sefedini ishte ende gjallë.

Duke patur parasysh të gjitha këto trupi gjykues gjen se mund të lehtësojë dënimin sic parashikohet në Nenin 30 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 2 të LPK sipas Nenit 9 paragrafi 3 i KP të RFSJ. Prandaj, dënimi që konsiderohet si i drejtë është tetë vjet burgim duke patur parasysh rrethanat e përmendura lehtësuese dhe faktin se nuk ka rrehtana rënduese.

Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri, nga 8 Nëntor 2003 deri në 24 Nëntor 2003 dhe nga 12 Qershori 2006 deri në 11 Dhjetor 2009, duhet të llogaritet në dënim, në përputhje me Nenin 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 dhe Neni 278 paragrafi 7 i KPPK.

### **Shpenzimet**

Meqenëse i pandehuri është shpallur fajtor, ai duhet të shlyejë kostot e procedurës penale në shumën e 500 Eurove, sipas Nenit 102 paragraph 1 of the KPPK, me përjashtim të përkthimit.

### **Kompensimi**

Në fillim të gjykimit kryesor palëve të dëmtuara i janë bërë të njohura mundësitë për të paraqitur një mocion për të realizuar kërkesat pasurore juridike brënda procedurës penale, por ata deklaruan se ata nuk kanë ndonjë synim për të paraqitur ndonjë kërkesë pasurore juridike.


Prandaj gjykata nuk kishte për të marrë një vendim të vecantë për këtë çështje,

### **Udhëzime Ligjore**

Personat e autorizuar mund të paraqisin një ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Pejës brënda pesëmbëdhjetë ditëve nga data marrjes në dorëzim të një kopje të aktgjykimit.

Procesmbajtëse

Robina Strutters



Kryetarja e trupit gjykues

Verginia Micheva-Ruseva,  
Kryetarja e trupit gjykues